Shoqeri e cila figuron e regjistruar ne Gjykaten e rrethit Tirane , me vendimin nr. 3193 date 31.3.1994,

## V E N D O S E M

1.Miratimin e aktit te ekspertimit kryer nga ekspertja Ajeta Shkembi per zmadhimin e kapitalit.
2. Miratimin e zmadhimit te kapitalit te shoqerise ne shumen prej 40.000.000 lek , duke shkuar ne shumen prej 70.000.000 leke.

3.Depozitimin e ketyre ndryshimeve ne regjistrin tregtar.

ORTAKET E SHOQERISE

| ZEF SHTJEFNI | GJOVALIN SHTJEFNI | ARTA SHTJEFNI |
|---|---|---|

Milis sh.p.k.
Fab. Tull. e Tjeg
Lezhe - Albania
K. Fisk: 210'4
TVSH: J 67902520 S
Tel., Fax: 003552622304
Mobil: 0382021266, 2222389

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NR. REP. 903

VERTETIM

Sot ne Tirane, me 11.02.2004, ne zyren e noterise,me seli ne rrugen "B.Gjergj Fishta", u paraqit personalisht:

KERKUESI: Zef Shtjefni,Gjovalin Shtjefni, Arta Shtjefni, ortake te shoqerise "MILIS ",rregjistruar ne gjykaten e Tiranes me vendimin nr.3193 date 31.03.94, me seli ne Lezhe,te njohur prej meje, madhor, me zotesi te plote juridike e per te vepruar,te cilet deklarojne se sa siper, kane nenshkruar sipas ligjit une noteri e vertetoj rregullisht.

N O T E R E

Taksa e pulles u pagua 100 lek

FATMARA SHEHU

3193/4

Z. M. Doçi
04 02 2004

04 SHKURT 2004

KERKESE

Kerkuesi : Ded Shtjefni, administrator I shoqerise " MILIS " SHPK , me seli ne lezhe.

OBJEKTI : DEPOZITIMI I VENDIMIT NR. 4 DATE 27.01. 2004 I samblese se ortakeve te shpk " MILIS ".
Ligji Per shoqerite tregtare

PERPARA GJYKATES SE SHKALLES SE PARE

TIRANE

Shoqeria " MILIS " SHPK , figuron e regjistruarne Gjykaten e Tiranes, e vendimin Nr. 3193 date 31.03. 1994, me seli ne Lezhe , me ortaket: Zef Shtjefni, Gjovalin Shtjefni dhe Arta Shtjefni, me administrator z. zef Shtjefni:
Me vendimin nr. 4 date 27.01. 2004 te asmablese se ortakeve eshte vendosur :

1. Te liroje nga detyra administratorin Zef Shtjefni dhe emerimi ne vendin e tij te z. Ded Shtjefni, lindur dhe banues ne Lezhe.
2. Te beje rritjen e kapitalit themeltar te shoqerise. ~~nga 30.000.000 lek ne 70.000.000 lek sipas kontributeve e posedimit te kuotave si vijon.~~

~~-Zef Shtjefni posedon 80 % te kuotave me kontribut 56.000.000 lek.~~

~~Gjovalin Shtjefni posedon 10 % te kuotave me kontribut 7.000.000 lek~~

~~-Arta Stjefni posedon 10 % kuota me kontribut 7.000.000 lek.~~

3. Caktohet z. Ajeta Shkembi si eksperte kontabel.
4. ~~Te beje ndryshimet e statutit te shoqerise sipas situates se re te krijuar me miratimin dhe nenshkrimin te ortakeve ne asamblene e dates 27.01.2004.~~

Te depozitohet
Kerkesa
1) Vendimi asamblese ortakeve
Nr 4 dt 27/1/2004
Me
Mernani
10/2/2004

ADMINISTRATORI
Ded Shtjefni

Milis sh.p.k.
Fab. Tull. e Tjeg
Lezhe - Albania
K. Fisk: 210' 4
TVSH: J 67902520 S
Tel., Fax: 003552622304
Mobil: 0382021266, 2222389

NOTER TIRANE

**MILIS SH.P.K.**
**Fabrika e tullave qeramike**
**Lezhe**
**Nr. 21/1 prot.**

*Lezhe,me 27.01.2004*

## V E N D I M

Ne mbledhjen e saj te dt.27.01.2004 Asambleja e ortakeve te shoqerise Milis krahas te tjerave

**vendosi:**

**1**.Te liroje nga detyra per aresye mbingarkese administratorin e shoqerise Milis sh.p.k. z. Zef Shtjefni.

**2**.Te ngarkoje me detyren e administratorit z. Ded Nikoll Shtjefni , i datelindjes 1940,lindur dhe banues ne Lezhe.

**3**.Te beje rritjen e kapitalit themelir te shoqerise ~~nga 30 000 000 leke 70 000 000 leke sipas kontributeve e posedimit te kuotave si vijon:~~
~~-Zef shtjefni posedon 80% te kuotave me kontribut 56 000 000 leke.~~
~~-Gjovalin Shtjefni posedon 10% te kuota me kontribut 7 000 000 leke.~~
~~-Arta Shtjefni posedon 10% kuota me kontribut 7 000 000 leke.~~

**4**.Te caktoje zonjen Ajeta Shkembi si eksperte kontabel.

~~**5**.Te beje ndryshimet e statutit te shoqerise sipas situates se re te krijuar me miratim dhe nenshkrimit te ortakeve ne asamblene e dates 27.01.2004.~~

| | | |
|---|---|---|
| **ADMINISTRATORI** | **ORTAKU** | **ORTAKU** |
| **Zef Shtjefni** | **Gjovalin Shtjefni** | **Arta Shtjefni** |

3193/3

30.12.2002

S M Ded.

27 12 2002

PULLE TAKSE 50 LEKE

**KERKESE**

**KERKUES:** Zef Shtjefni dtl 1960, lindur dhe banues ne Lezhe

**OBJEKTI** ;Depozitimin e dokumentave te paraqitura ne emer te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar te emertuar " MILIS " Sh.P .K

**BAZA LIGJORE** : Ligji 7638 dt 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare " dhe ligji 7667 dt 28.01.1993 "Per regjistrat tregtar "

PERPARA GJYKATES SE SHKALLES SE PARE
TIRANE

Une kerkuesi ortak i vetem dhe administrator i shoqerise "MILIS " Sh.P.K me vendimin Nr 4 te ortakut te vetem dt 23.12.2002 kam vendosur ;

-Pranimin ne shoqeri te ortakeve Gjovalin Shtjefni dhe Arta Shtjefni .

Ortakeve te pranuar ne shoqeri u kam shitur pjese nga kapitali themetar i shoqerise sipas kontrates se shitjes dt 23.12.2002

Kerkoj depozitimin e ketyre dokumentave ne Zyren e regjistrit Tregtar te Gjykates se shkalles se Pare Tirane .

Te depozitohet kerkesa
-vendimi i ortakut te vetem Nr. 4 dt 26-12-02.
-kontrata shitje Nr. 5381 Rep dt 26-12-02 noter Hegir Mursi
Dt. 30-12-02
gjyqtare Dedi

**KERKUESI**
**Zef Shtjefni**

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
Nr 5379 rep

VERTETIM

Ne Tirane sot me dt 26.12.20002 para meje noterit u paraqit personalisht Zef Shtjefni , madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar i cili me deklaroi se sa me siper eshte shprehur vullneti i tij i lire dhe i plote.Pasi nenshkroi rregullisht para meje noterit une e vertetoj ate sipas ligjit.

NOTER
Hegir Mursi

PULLE TAKSE 50 LEKE

**VENDIM NR 4 I ORTAKUT TE VETEM TE SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR TE EMERTUAR "MILIS " SH.P.K**

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "MILIS " Sh.P.K eshte regjistruar person juridik me vendimin 3193 dt 31.03.1994 te Gjykates se shkalles se Pare Tirane ku aktualisht ortak i vetem dhe administrator eshte Zef Shtjefni .

Sot me dt 23.12..2002 shqyrtova kerkesen e Gjovalin Shtjefni dhe Arta Shtjefni per tu futur ortak ne shoqerine time.

Mbeshtetur ne aktet e themelimit te shoqerise si dhe ne ligjin 7638 dt 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare " dhe ligjit 7667 dt 28.01.1993 "Per regjistrat tregtar"

**VENDOSA**

Te pranoje ortak ne shoqeri Gjovalin Shtjefni dhe Arta Shtjefni .

Ortakeve te rinj ne shoqeri do ti shes pjese nga kapitali themeltar te shoqerise ne masen 10 % secilit qe i perket secilit perkatesisht shuma 3.500.000 leke .

Ortaket e rinj ne shoqeri marrin persiper detyrimet e aktivit dhe pasivit te bilancit te shoqerise nga moment i hyrjes ne shoqeri.

Te depozitohen keto dokumente ne Zyren e Rregjistrit Tregtar te Gjykates se shkalles se Pare Tirane .

**ORTAKU I VETEM DHE ADMINISTRATOR**
**Zef Shtjefni**

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
Nr 5380 rep

VERTETIM

Ne Tirane sot me dt 26.12.20002 para meje noterit u paraqit personalisht Zef Shtjefni , madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar i cili me deklaroi se sa me siper eshte shprehur vullneti i tij i lire dhe i plote.Pasi nenshkroi rregullisht para meje noterit une e vertetoj ate sipas ligjit.

NOTER

R. Sh. SHQIPERISE NEZIR MURATI NOTER TIRANE
Gjyqe ... Zenuni
Nr 3381 R...

**KONTRATE-SHITJE KUOTASH**

PULLE TAKSE 50 LEKE

Ne Tirane sot me dt 26.12.2002, para meje noterit ..Nezir..Muratit..... u paraqiten palet ne kontraten e shitjes me cilesite e meposhtme :

**SHITESI** ; Zef Shtjefni , dtl 1960, lindur dhe banues ne Lezhe , madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.

**BLERESIT** :1.Gjovalin Shtjefni i biri i Dedes, dtl 1968, lindur dhe banues ne Lezhe .

2.Arta Shtjefni e bija e Irfanit , dtl 1959, lindur dhe banues ne Lezhe .

Shitesi Zef Shtjefni eshte pronar i kapitalit themeltar ne masen 35.000.000 leke te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "MILIS " Sh.P.K .

Kete pronesi e vertetoj edhe me vendimin Nr 3193/3 dt 13.12.2002 te Gjykates se shkalles se Pare Tirane .Nga ky kapital iu shet Gjovalin Shtjefnit dhe Arta Shtjefnit 10% kuota secilit perkatesisht ne masen 3.500.000 leke .

Pas lidhjes se kesaj kontrate kapitali themeltar i shoqerise eshte i ndare midis ortakeve si me poshte :

Zef Shtjefni 80% te kapitalit ne masen 28.000.000 leke
Gjovalin Shtjefni 10% te kapitalit ne masen 3.500.000 leke
Arta Shtjefni 10% te kapitalit ne masen 3.500.000 leke

Ortaket ne momentin e hyrjes ne shoqeri marrin persiper aktivin dhe pasivin e shoqerise .

Kontrata pasi u lexua nga palet u gjend e shkruar ne rregull sipas deshires dhe vullnetit te tyre te plote dhe te lire nenshkruar para meje noterit une e vertetoj firmen sipas ligjit .

SHITESI

Zef Shtjefni

BLERESIT

Gjovalin Shtjefni

Arta Shtjefni

Noter
Nezir Murati

3198/2 **KERKESE**

3 M Dedi
12 12 2002

KERKUES Zef Shtjefni , dtl 1960, lindur dhe banues ne Lezhe

OBJEKTI ;Depozitimin e dokumenteve te shoqerise "MILIS " SH.P.K

BAZA LIGJORE : Ligji 7667 dt 28.01.1993 dhe Ligjit Nr 7638 dt 19.11.1992 .

## PERPARA GJYKATES SE SHKALLES SE PARE TIRANE

Shoqeria "MILIS"eshte regjistruar person juridik me vendimin Nr 3193 dt 31.03.1994 te Gjykates se shkalles se Pare Tirane , ku aktualisht jane ortak Armando Bonetti dhe Zef Shtjefni , me administrator Zef Shtjefni . Gjendja e kapitalit aktualisht eshte 35.000.000 leke te reja . .
Me vendimin nr 3 dt 07.09.2002 te asamblese se ortakeve eshte vendosur qe te largohet ortaku i shoqerise Armando Bonetti duke ngleur ortaku i vetem dhe administrator Zef Shtjefni.Eshte bere kontrata e shitjes .

Ju lutemi miratoni kerkesen time.

Te depozitohet kerkese. vendimi i ortakeve dt. 07.10.02. - Kontrate shitje Nr. 1502/543. noter Vasil Marku dt 13.12.02
Gjyqtare N. Dedi

KERKUES
Zef Shtjefni

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NR 2820 REP

**VERTETIM**

Ne Tirane sot me dt 07.10.2002 para meje noterit u paraqit personalisht Zef Shtjefni, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar i cili me deklaroi se sa me siper eshte shprehur vullneti i tij i lire dhe i plote.Pasi nenshkroi rregullisht para meje noterit une e e vertetoj ate sipas ligjit .

Notere
Hatixhe Gojani

**<u>V E N D I M NR 3</u>**
**<u>TE ASAMBLESE SE ORTAKEVE TE SHOQERISE</u>**
**<u>"MILIS " Sh.P.K</u>**

Asambleja e ortakeve te shoqerise "MILIS" e perbere nga Zef Shtjefni dhe Armando Bonetti , regjistruar person juridik me vendimin e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane nr 3193 dt 31.03.1994 mori ne shqyrtim kerkesen e Z.Zef Shtjefni per tu larguar nga shoqeria "MILIS " Sh.P.K ortaku Armando Bonetti duke ia kaluar pjesen e tij ne masen 60% z.Zef Shtjefni .

Pasi diskutoi kete problem u

<u>V E N D O S</u>

Te largohet nga shoqeria ortaku Armando Bonetti . Kuotat e ortakut Armando Bonetti , te cilet perbejne 60% te kapitalit ne masen 21.000.000 leke ti shiten z. Zef Shtjefni .

Vendimi u mor me vota unanime.

<u>O R T A K E T</u>

Zef Shtjefni

Armando Bonetti

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NR 2822 REP
NR — KOL

<u>V E R T E T I M</u>

Ne Tirane sot me dt 04.10. 2002 para meje noterit u paraqiten personalisht Z.Zef Shtjefni dhe Z.Armando Bonetti madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar te cilet me deklaruan se sa me siper eshte shprehur vullneti i tyre i lire dhe i plote. Pasi nenshkroi rregulisht para meje noterit une e vertetoj ate sipas ligjit .

N O T E R

Halishe Gjoni

PULLE TAKSE
100 LEKE
R.SHQIPERISE

PULLE TAKSE
50 LEKE
R.SHQIPERISE

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**MINISTRIA E DREJTESISE**
**NOTERI V.MARTINI**
Nr. 1702 regj.
Nr. 593 kol.

## KONTRATE SHITJE

ora 17.30

Sot,me date 07.09.2002 ,ne Lezhe para meje noter Vasil Martini u paraqiten palet:

1. Armando Bonetti,lindur ne Parma Itali me 25.09.1939 dhe banues ne Miliano per identitetin e te cilit u sigurova nga pasaporta qe mbante me vete dhe nga njohja ime personale ,me cilesine e pales shitese.

2.Zef Shtjefni i datelindjes 10.04.1960 ,lindur dhe banues ne Lezhe per identitetin e te cilit u sigurava nga njohja ime personale,me cilesine e pales blerese.

Te dyja palet kerkuan nga une noteri redaktimin e tekstit te meposhtem te kesaj kontrate: Armando Bonetti posedon 60 % (gjashtedhjete perqind) te kuotave te sh.p.k MILIS (Fabrika e tullave Lezhe),c'ka vertetohet me statutin e shoqerise ne fjale dhe vendimin e Gjykates se Tiranes nr.3193/2 dt.27.09.2000.Keto kuota totalisht permes kontrates se premtimit te shitjes te dates 27.07.2000 pika 2 ,Armando Bonetti ia ka shitur ortakut te vet Zef Shtjefni.,baraz me 21.000.000 leke.

Armando Bonetti deklaron se eshte likujduar totalisht nga Zef Shtjefni per cmimin e rene dakord dhe me kete akt largohet perfundimisht nga sh.p.k Milis,duke ia kaluar totalin e 60% te pronesise se kuotave te tij, Zef Shtjefnit.Ne kete menyre Zef Shtjefni qe ne kete moment zoteron 100%(njeqind per qind)te kuotave te Milis sh.p.k,e cila posedon Fabriken e tullave Lezhe.

Zef Shtjefni gjithashtu deklaron se e ka pranuar dhe likujduar teresisht cmimin e rene dakord me Armando Bonettin ne perputhje te plote me kontraten e dt.27.07.2000 te firmosur me deshiren reciproke te te dyja paleve.

Te dyta palet deklarojne se cdo gje e kane bere me vullnetin e tyre te lire dhe konform statutit te shoqerise dhe ligjeve shqiptare ne fuqi,cka konfirmohet edhe nga une noteri.Per vertetimin e sa me siper, ftova palet ne prezencen time te nenshkruajne kete kontrate si me poshte.

PER PALEN SHITESE
Armando Bonetti
A. Bonetti

PER PALEN BLERESE
Zef Shtjefni
Shtjefni

NOTERI
VASIL MARTINI

K E R K E S E

KERKUESI :Zef Shtjefni, lindur e banues ne Lezhe, me cilesine e administratorit te shoqerise.

OBJEKTI ; Depozitim i vendimit te Asamblese se Ortakeve te datas 19.09.2000 per ndryshimin administratorit te shoqerise MILIS SHPK .

PERPARA GJYKATES SE RRETHIT

T I R A N E

Me vendimin nr.2143/1, date 03.07.1998 te Gjykates se Rrethit Tirane shoqeria me pergjegjesi te kufizuar MILIS shpk ka bere ndryshimin e administratorit te shoqerise, ku mbas ndryshimeve administrtaor i shoqerise eshte Armando Bonetti.

Me vendimin nr.2 date 12.09.2000 te ASAMBLESE SE ORTAKEVE eshte vendosur ndryshimi i detyres se administratorit te shoqerise. Kjo behet me kerkese te z. Armando Bonetti i cili kerkon doreheqjen nga kjo detyre dhe eshte dakord qe administrator te jete Zef Shtjefni. Pra administrator i shoqerise u vendos Zef Shtjefni.

Kerkoj te behen keto ndryshime ne skeden perkatese te kesaj shoqerie ne Zyren e Regjistrit Tregtar prane Gjykates suaj.

KERKUESI
Zef Shtjefni

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA TIRANE
Nr. 4957 Rep.

V E R T E T I M

Vertetojme se sot, me date .09.2000, para meje noteres u paraqit kerkuesi Zef Shtjefni, per identitetin e te cilit pasi u sigurova nga leternjoftimi perkates, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i cili deklaroi se sa me siper u be me vullnetin e tij te lire dhe te plote dhe nenshkroi para meje noteres, dhe une noterja e vertetoj sipas ligjit.

PULLE TAKSE

PULLE TAKSE
50 LEKE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
SHOQERIA "MILIS" SHPK

V E N D I M NR.2

I MBLEDHJES SE ZAKONSHME TE ASAMBLESE

Me vendimin nr.2143/1, date 03.07.1998 te Gjykates se Rrethit Tirane shoqeria me pergjegjesi te kufizuar MILIS shpk ka bere ndryshimin e administratorit te shoqerise, ku mbas ndryshimeve administrtaor i shoqerise eshte Armando Bonetti.

Sot, me date 12.09. 2000 duke marre ne shqyrtim rendin e dites kerkesa e administratorit Armando Bonetti i cili kerkon te jape doreheqjen nga kjo detyre ;

V E N D O S E M :

- Qe te pranohet kerkesa per doreheqjen nga detyra e administrtorit te shoqerise MILIS SHPK z. Armando Bonetti.

- Detyren e administratorit te shoqerise do ta kryej z. Zef Shtjefni, i cili meqenese eshte edhe ortak ,eshte dakord ta kryej kete detyre per mbarevatjen e punes te shoqerise.

- Te depozitohen aktet,per ndryshimin e administratorit te shoqerise nga z. Armando Bonetti tani administrator do te jete Z. Zef Shtjefni, prane Zyres se Regjistrit Tregtar.

O R T A K E T

ARMANDO BONETTI          ZEF SHTJEFNI

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA TIRANE
Nr. 4158 Rep.

V E R T E T I M

Vertetojme se sot, me date .09.2000 , para meje noteres u paraqit kerkuesit Armando Bonetti dhe Zef shtjefni, per identitetin e te cilit pasi u sigurova nga leternjoftimi perkates, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i cili deklaroi se sa me siper u be me vullnetin e tij te lire dhe te plote dhe nenshkroi para meje noteres, dhe une noterja e vertetoj sipas ligjit.

Noter

# K E R K E S E

KERKUESIT 1. Zef Shtjefni banues ne Leshe
2. Armando Bonetti shtetas Italian Banues perkohesisht ne qytetin e Lezhes

OBJEKTI , Kerkohet depozitimi i vendimit Nr. 1 date 24.06.1998 i Asamblese se Ortakeve te Shoqerise "MILIS" shpk. Leshe

Perpara

## GJYKATES SE RRETHIT TIRANE

Ne baze te aktit te themelimit dhe statutit te nenshkruar nga ortaket , me vendim Nr. 2143 date 31.03.1994 te gjykates se rrethit Tirane , eshte regjistruar si person juridik shoqeria " MILIS " shpk , Leshe .

Me vendimin Nr. 1 date 24.06.1998 te Asamblese se ortakeve , u bene disa ndryshime dhe konkretisht ;

1. Administratori i Shoqerise do te jete Armando Bonetti , ndersa z. Zef Shtjefni deri tani administrator do te jete votues me cilesine e ortakut ne kete shoqeri.

2. Pjesemarrja e Kapitaleve ndryshohet dhe behet si vijon ;

a) Armando Bonetti nga 80 % te kapitaleve qe zoteronte do te kete 60 % te tyre .

b) Zef Shtjefni nga 20 % te kapitaleve qe zoteronte do te kete 40 % te tyre

Si siper kerkojme depozitimin e ketij vendimi te asamblese se ortakeve te shoqerise " MILIS " shpk ne regjistrin tregtare te Gjykates se Rrethit Tirane .

Bashkengjitur ju dergojme vendimin e asamblese se ortakeve si dhe kopjen e vendimit te gjykates se rrethit Tirane te regjistrimit te shoqerise " MILIS " si person juridik .

K E R K U E S I T

ARMANDO BONETTI    ZEF SHTJEFNI

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA TIRANE
NR. 1154 REP

## VERTETIM

Sot me date 29.06.1998 , ne zyren e noterise Tirane perpara meje noteres Elida Teke u paraqiten personalisht ;

1. Armando Bonetti dhe Zef Shtjefni per identitetin e te cileve u sigurova nga pasaportat perkatese te cilet deklaruan se kerkesa e tyre e mesiperme shpreh vullnetin e tyre te lire dhe une noterja e vertetoj .

N O T E R E

REPUBLIKA E SHQIPERISE
SHOQERIA MILIS SHPK LEZHE

V E N D I M
NR. 1, DATE 03.03.1998

TE ASAMBLESE SE ORTAKEVE TE SHOQERISE

Asambleja e ortakeve te shoqerise "MILIS" shpk me pergjegjesi te kufizuar Lezhe me dat. 24.06.1998, mori vendimin nr.1 per disa ndryshime ne veprimtarine e kesaj shoqerie te cilat parashikohet ne Statut duke ndryshuar administratorin e kesaj shoqerie, si dhe pjesemarrjen e kapitaleve.

PER KETO ARSYE

V E N D O S A ;

Administratori i shoqerise do te jete Armando Bonetti, ndersa z. Zef Shtjefni deri tani administrator do te jete vetem me cilesine e ortakut ne kete shoqeri.

Pjesemarrja e kapitaleve ndryshohet dhe behet si vijon;

Armando Bonetti nga 80 % e kapitaleve qe zoteronte do te kete 60 % te tyre.

Zef Shtjefni nga 20 % te kapitaleve qe zoteronte do te kete 40 % te tyre, sipas kontrates se shitjes.

SHOQERINE "MILIS" SHPK

ARMANDO BONETTI — ZEF SHTJEFNI

DHOMA E NOTERISE TIRANE
NR. 1184 Rep.

V E R T E T I M

Ne Tirane sot me date 03.07 .1998 ne zyren e noterise u paraqiten personalisht z. Armando Bonetti, Zef shtjefni me banim ne Lezhe,madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, te cilet deklarojne se kete vendim e kane redaktuar jashte kesaj zyre me vullnetin e tyre te lir dhe te plote e firmosin ate para meje dhe une noterja e vertetoj ate sipas ligjit.

N O T E R E

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERE
TIRANE

PULLE TAKSE 50

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NR. 642 Rep.
Nr. 114 Kol.

KONTRATE SHITBLERJEJE

Sot, me date 02.03.1998 (nentedhjet e tete) para meje noteres Elida Take te Dhomes se Noterise Tirane, u paraqiten personalisht palet kontraktuese me cilesite e meposhtme :

SHITESI ; ARMANDO BONETTI, i biri i Di Vittorio, dtl. 25.04.1939 me banim te perkohshem ne Lezhe,me zotesi te plote juridike per te vepruar.

BLERESI: ZEF SHTJEFNI, i biri i Dedes dhe i Terezes, dtl. 10 prill 1960 lindur e banues ne Lezhe,madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar,

Te cilet kerkuan te lidhet kontrata e shitblerjes si me poshte :

Me vendim nr.2143 te dates 31.03.1994 te Gjykates se RrethitTirane eshte krijuar shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "MILIS" shpk Lezhe me dy ortak Armando Bonetti dhe Zef Shtjefni te cilet zoterojne i pari 80 % kuota te kapitalit, kurse Zef Shtjefni 20 %.

Armando Bonetti dhe Zef Shtjefni deklarojne se me vullnetin e tyre te lire dhe te plote se z. Armando Bonetti ia shet 20 % kuotave te kapitalit te tij ortakut tjeter Zef Shtjefnit, i cili me blerjen e tyre ndryshohet raporti i kuotave te kapitalit te shoqerise. Tani z. Armando Bonetti zoteron 60 % kuota nga kapitali i shoqerise, kurse z. Zef Shtjefni zoteron 40 % kuota nga kapitali i kesaj shoqeri.

Kontrata mbasi u lexua dhe u gjet sipas vullnetit te tyre te lire dhe te plote nenshkruhet rregullisht prej tyre para meje noteres dhe une noterja e vertetoj sipas ligjit.---

PALET

SHITESI
ARMANDO BONETTI

BLERESI
ZEF SHTJEFNI

Notere
Elida Take

REPUBLIKA E SHQIPERISE
ELIDA TAKE
NOTERE
TIRANE

PULLE TAKSE
50
LEKE
R.SHQIPERISE

Te riregjistrohet
31.03.1994

(3/93)

(3/93)

K E R K E S E

Kerkues: Zef Shtjefni perfaqesues i shoqerise italo - shqiptare "M I L I S " s.r.l

Objekti: Regjistrimi si person juridik i shoqerise shqiptaro - italiane MILIS ne baze te ligjit 7638 date 19.11.1992.

PERPARA GJYKATES SE RRETHIT TE TIRANES.

ZOTI KRYETAR,

Ne baze te ligjit nr.7638 date 19.11.1992 kerkoj te bej regjistrimin e shoqerise italo-shqiptare MILIS srl me objekt veprimtarie:Prodhimin dhe shitjen e materialeve te ndertimit etj. aktivitete plotesuese te lidhura me te.

Adresa e shoqerise do te jete:Lagjia e Fabrikes se Tullave LEZHE.

Kapitali themelor i shoqerise do te jete:35 000 000 (tridhjete e pese milione leke) te reja.

Administratori do te jete z. Zef Shtjefni dhe keshilltar z. Armando Bonetti.

K E R K U E S

ZEF SHTJEFNI

K O N T R A T E
E THEMELIMIT TE SHOQERISE ITALO-SHQIPTARE "MILIS" S.R.L
ME SELI NE TIRANE

Neni 1
Bazuar ne ligjin 7667 date 28.1.1993 "Per regjistrimin tregtrar" dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqeria italo shqiptare MILIS srl,perberja e saj eshte si me poshte:
1.Zef Shtjefni,i biri i Dedes i dtl.1960,banues ne Lezhe,rruga "Beselidhja",pallati 137.
2.Armando Bonetti,i biri i Vitorios i dtl.1939,banues ne Milano,Piazza P.Clotilde nr.6
Neni 2.
Vendqendrimi i shoqerise do te jete ne qytetin e Lezhes,ne lagjen ku ndodhet Fabrika e tullave.Shoqeria mund te hape filiale edhe ne rrethe dhe vende te tjera.
Neni 3.
Shoqeria do ta vazhdoje veprimtarine e saj me se 20 vjet me te drejte rinovimi te kesaj kohe me deshiren e ortakve.Permbajtja e kontrates gjithnje do te behet me shkrim
Neni 4.
Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete: Prodhimi dhe shitja e materialeve te ndertimit e aktivitete te tjera qe lidhen me te si shitblerja e pjeseve te kembimit,lende te para e ndihmese,karburante e lubrifikante,eksport import,investime per blerje dhe ndertime ne turizem e banesa etj ne territorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte saj.
Neni 5.
Ne fillim te veprimtarise ekonomiko financiare shoqeria disponon nje kapital fillestar prej 35 000 000 lekesh te investuara nga ortaket.
Ortaket marrin pjese ne krijimin e kapitalit themelor ne masen: Zef Shtjefni 7 000 000 leke.
Armando Bonetti 23 000 000 leke.
Duke patur para sysh kontributin e dhene nga secili ortak ne formimin e kapitalit themelor,z.Zef Shtjefni do te kete 20 % te kuotave te shoqerise dhe z.Armando Bonetti 80 %.
Neni 6
Kapitali i shoqerise mund te shtohet sipas rritjes se veprimtarise ekonomike te saj.Te ardhurat do te sigurohen nepermjet veprimtarise private te percaktuara ne nenin 4 te kesaj kontrate.
Neni 7.
Fitimet e arritura ne veprimtarine private ortaket do ti ndajne 20 % Zef Shtjefni dhe 80 % Armando Bonetti.
Neni 8.
Pjesetaret ne shoqeri kane te drejte te japin mendime,te kontrollojene veprimet financiare qe do te kryej shoqeria e tyre.
Neni 9.
Ortaket do te jene pergjegjes per cdo thyerje te rregullave ligjore,ekonomike e financiare te aktivitetit te tyre.
Neni 10.
Ortaket kane per detyre te marrin pjese ne rreziqet e

veprimtarise se shoqerise deri ne masen e plote te kapitalit financiar.
Neni 11.
Kontrata nenshkruhet nga ortaket ne baze te statutit te miratuar prej tyre per krijimin e shoqerise se perbashket private te emeruar "MILIS" srl.
Neni 12.
Kembimi i monedhes shqiptare ne monedhe te huaj e anasjelltas do te behet sipas rastit ne Banken e Shtetit shqiptar,sipas kursit te saj, ose ne tregun e lire te valutes.
Neni 13.
Mardheniet e punes ne shoqeri rregullohen nepermjet kontratave te punes,sic percaktohen ne legjislacionin shqiptar te punes.
Neni 14.
Ortaket kane per detyre te zbatojne rregullat e inspektoriateve te ndryshem si te atij financiar, te sigurimit teknik,higjeno sanitar.
Neni 15.
Kontrata eshte e vlefshme per 20 vjet me te drejte ripertertje te saj.Ne rast te mos plotesimit te detyrimeve secili ortak ka te drejte te kerkoje prishjen e kontrates brenda 30 ditesh.
Largimi nga ortakeria nuk i shmang ato nga detyrimet dhe te drejtat qe rrjedhin nga statuti i shoqerise te lidhura para largimit nga shoqeria.
Neni 16.
Per mosmarreveshje qe mund te lindin midis ortakeve dhe midis personave te trete fizike a juridike,zgjidhen me mirekuptim.Ne rast te kundert palet i drejtohen gjykates.
Neni 17.
Asambleja e ortakeve do ti jape prioritet punesimit te ish te perndjekurve politike,siupas nevojave te punes e aftesive te tyre dhe ish punetoreve qe tashme jane ne asistence sociale.
Neni 18.
Kontrata hartohet ne kater kopje ne gjuhen shqipe, e cila pasi u lexua nga ortaket dhe u miratua prej tyre,nenshkruhet pa asnje verejtje.
Kjo kontrate hyn ne fuqi pasi te nenshkruhet nga palet
Kontrata u nenshkrua sot me 5 janar 1994 ne Lezhe.

O R T A K E T

ZEF SHTJEFNI

ARMANDO BONETTI

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTER
TIRANE

# ASAMBLESE SE ORATKEVE TE SHOQERISE

## " MILIS" sh.p.k
## L E Z H E

**PROJEKTE MBI ZMADHIMIN E KAPITALIT me perfshirjen e rezervave**

Me vendim te dates 27.01.2004, te Asamblese se Ortakeve te shoqerise "MILIS" sh.p.k Lezhe, me eshte drejtuar mua si Eksperte Kontabel e Autorizuar, me nr 6 date 10.02.2000, te licenses, per te paraqitur nje projekte mbi zmadhimin e kapitalit me perfshirjen e rezervave.

Une si Eksperte Kontabel e Autorizuar, e pranova misionin e percaktuar ne vendimine Asamblese se Ortakeve, duke patur parasyshe kerkesat e nenit 168,169 te ligjit nr 7638 date 19.11.1992, "Per shoqerite Tregtare", mbi papajtueshmerite mbi emerimin e Ekspertit kontabel te autorizuar.

Per te kryer kete misione,nga ana e shoqerise me eshte vene ne dispozicion , pasqyrat financiare te ushtrimit 2003, si dhe te gjitha dekumentat e tjera qe e bene te besueshem kete projekte.

Ne cilesin time si Eksperte Kontabel e Autorizuar dhe ne zbatim te misionit te parashikuara nga neni 150 te ligjit nr 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare", po ju paraqesim raportin tone mbi projektin e zmadhimit te kapitalit.

Une kame proceduar ne kontrollin e informacionit te dhene ne raportin e administrimit dhe te pasqyres financiare, per kete mision dhe konkretishte;

-mbi motivin e zmadhimit e kapitalit te nenshkruar
-mbi zgjedhjen e elementeve te llogaritjes se cmimit te emisionit dhe shumes se tij

Nje nga arsyet me kryesore, qe ka bere te domosdoshme zmadhimin e kapitalit me perfshirjen e rezervave dhe fitimeve eshte:

Nevoja per te ri investuar fitimet e tyre ne shoqerin per te financuar investimet e programuar per te ardhmen nga vete ortaket e shoqerise.

A. Mondalitetet dhe rregullat e zmadhimit do te realizohet.

1.Zmadhimi I kapitalit do te realizohet ndermjete emetimi te pjeseve te reja ne shumen prej 40.000.000 leke, ose 40.000 pjese, pa hyrjen e ortakeve te rinje.

2.Menyra e shlyrjes se pjeseve te reja me perfshirjen e rezervave do te behet,(ndryshe nga zmadhimi I kapitalit themeltare me para ne dore,) sepse kjo procedure nuk kushtezohet me shlyrjen teresore te kapitalit para zmadhimit( asnje dispozite ligjore nuk ekziston per kete ceshtje)

3 Zmadhimi I kapitalit themeltare me perfshirje e rezervave nuk ka te beje me ndonje ndryshim te madhesise te aktivit neto apo te kapitaleve te veta te shoqerise, sepse nuk ka hyrje te kapitaleve te reja

4. E drejta perparesise ne nenshkrimin e pjeseve te kapitalit

Sipas nenit 154 , te ligjit nr 7638 date 19.11.1992, Per "Shoqerite Tregatre"perpara se te behet cdo emetim I pjeseve te reja qe shlyhen me para ne dore, duhet qe kapitali I nenshkruar perpara se te behet zmadhimi I kapitalit duhet te jete shlyer plotesishte.

Nga ana jone , duke u mbeshtetur ne pasqyrat financiare te ushtrimit 2003, te cilat jane te certifikuar nga ana jone , rezulton se kapitali fillestare I nenshkruar ne shumen prej 30.000.000 leke eshte shlyer tersishte dhe I konfirmuar me vendim nr 3193 date 31.03.1994, te Gjykates se Rrethit Tirane, e cila eshte e rakorduar dhe e pasqyruar ne rubriken e kapitaleve te veta ne postin kapital I nenshkruar, ne shumen prej 30.000.000 leke

Sipas nenit 155 te ligjit nr 7638 date 19.11.1992, Ortaket e shoqerise , kane nje te drejte perparesie ne nenshkrimin e pjeseve te reja ,per cdo ortake ka te drejten e nenshkrimit te nje numri aksione te percaktuara ne perpjestim me te drejten e shumes se pjeseve qe ai zoteron ne momentin e zmadhimit te kapitalit dhe konkretishte:

Kapitali fillestare ne shumen prej 30.000.000 leke eshte ndare ne30.000 pjese:

Ku ne baze te nenit 38 te ligjit nr 7368 date 19.11.1992, "Per Shoqerite Tregatre" eshte percaktuar vlera nominale e nje pjese te kapitalit qe eshte e barabaret me 1000 leke e ndare sipas ortakeve:

1. Zef Shtjefni 80% ne vlere ne shumen prej 24.000.000 leke
2. Arta Shtjefni 10% ne vlere ne shumen prej 3.000.000 leke
3. Gjovalin shtjefni 10% ne vlere ne shumen prej 3.000.000 leke

**REZERVAT QE MUND TE PERFSHIHEN NE KAPITALIN THEMELTARE**

Te gjitha rezervat, perfshire edhe ate te domosdoshme (ligjore), mund ti bashkohet kapitalit themeltare, madje edhe primet apo fitimet e nje ushtrim mund te kapitalizohen, dhe sipas nenit 150 pargrafi 2, keto rezeva do ti bashkohen kapitalit themletare pasi ne bilancet kontable te shoqerise nuk ka humbje te mbartura.

Rezervat jane si me poshte:

| | |
|---|---|
| 1.Rezerva ligjore | 3.500.000 leke |
| 2. Rezerva statutore | 12.364.231 leke |
| 3.Fitimet e mbartura | 14.435.769 leke |
| 4.Provigjone(lehtesira tatimore 1994) | 9.700.000 leke |
| TOTALI | 40.000.000 leke |

Te gjitha kete rezerva jane te pasqyruara ne bilancin e ushtrimit 2003, ne rubriken e kapitaleve te veta te cilat jane edhe te certifikuara.

Bilanci I ushtrimit 2003, rezulton si me poshte:

| AKTIVI | | PASIVI | |
|---|---|---|---|
| AQT | 81.852.984 leke | Kapitalete veta | |
| AQ | 32.401.670 leke | -kapitali I nenshkruar | 30.000.000leke |
| | | -Rezera ligjore | 3.500.000leke |
| | | - rezerva statutore | 12.364.231leke |
| | | - fitimet | 14.597.935leke |
| | | -provigjone | 51.932.713lek |
| | | B DETYRIMET | 1.8759.791 leke |
| Totali | **114.254.654** leke | Totali | **114.254.654** leke |

Mbase zmadhimit te kapitalit themeltare bilanci pasqyrohet si me poshte:

| AKTIVI | | PASIVI | |
|---|---|---|---|
| AQT | 81.852.984 leke | Kapitalet e veta | |
| AQ | 32.401.670 leke | - Kapitali I nenshkruar | 70.000.000 leke |
| | | - fitimet | 162.166leke |
| | | -provigjonet | 42.232.713 leke |
| | | B Detyrimet | 1.859.791 leke |
| Totali | **114.254.654** leke | totali | **114.254.654** leke |

Pra sic rezulton edhe nga bilancet , zmadhimi I kapitalit me perfshirjen e rezervave nuk ndryshone madhesia e aktivit neto apo kapitalet e veta te shoqerise.

Ndarja e kuotave sipas ortakeve mbase zmadhimit te kapitalit rezulton:

1. Zef Shtjefni 80% te pjeseve te kapitalit ,ne vleren prej 56.000.000leke ose 56.000 pjese.
2. Arta Shtjefni 10% te pjeseve te kapitalit, ne vleren prej 7.000.000leke ose 7.000 pjese.
3 Zef Shtjefni 10% te pjeseve te kapitalit, ne vleren prej 7.000.000 leke 0se 7.000 pjese.

## KONKLUZION

Si rezultat I verfikimeve te bera dhe duke patur parasyshe eshe hollesite e dhena me siper ne cmojme qe vlera neto kontabel e elementeve qe perbejne aktivin e shoqerise dhe kapitalet e shoqerise, ashtu sic dalin edhe nga pasqyrat financiare qe I jane aneksuar ketij raporti jane ne pajtueshmeri me rregullat dhe parimet kontable dhe perbejne nje vleresim normal dhe te arsyeshem.

Dhe si perfundim te operacionit te zmadhimit te kapitalit, mendoje se misioni im mbi kete operacion ka perfunduar , ky vleresim I paraqitet per miratim Asamblese se Ortakeve.

EKSPERTE KONTABEL E AUTORIZUAR

/ Ajeta SHKEMBI /

TIRANE me 05.02.2004

Eksperte Kontabel e Autorizuar
AJETA SHKEMBI
Nr. Liç 6
ALBANIA

REPUBLIKA E SHQIPERISE

DHOMA E NOTERISE TIRANE

NR. REP. 902

## VERTETIM NENSHKRIMI

Sot ne Tirane, me date 11.02.2004 para meje noteres Fatmara Shehu, me seli ne rrugen B."Gjergj Fishta" , u paraqit personalisht:

Aketa Shkembi, banuese ne Tirane, e njohur prej meje, me cilesine e ekspertes kontabel e autorizuar, e cila deklaroi se sa siper, ka nenshkruar sipas ligjit, une noteri e vertetoj sipas ligjit.

N O T E R E

FATMARA SHEHU

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATE E RRETHIT TIRANE
Nr. 5/85 Vendimit

V E N D I M

MBI REGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK TE SHOQERISE ITALO - SHQIPTARE "M i l i s " SRL.

Une, Donika Deti, gjyqtare ne Gjykaten e rrethit te Tiranes, sot me daten 31.3.1994 mora ne shqyrtim kerkesen e kerkuesit Zef Shtjefni, me te cilen ai kerkon regjistrimin e shoqerise italo-shqiptare"MILIS"srl si person juridik, me qender ne qytetin e Lezhes,

K O S T A T O V A

Se kerkuesi Zef Shtjefni ka bere kerkese prane kesaj Gjykate per regjistrimin si person juridik te shoqerise MILIS srl te themeluer me ortakun italian Armando Bonetti, per te ushtruar veprimtarine ne fushen e prodhimit dhe te shitjes se materialeve te ndertimit e veprimtari te tjera te lidhura me kete; si shitblerje pjesesh te kembimit, lende te para e ndihmese, lubrifikante e karburante, import eksport, investime per shitblerje e ndertime ne turizem e banesa etj., ne territorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte saj.

Kerkesa e tij eshte e bazuar ne ligj, prandaj duhet te pranohet.

P E R K E T O A R E S Y E

Ne baze te ligjit nr. 7512 date 10.08 1991 dhe te ligjit nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite private",

V E N D O S A

Regjistrimin si person juridik te shoqerise italo-shqiptare"MILIS" s.r.l. me qender ne Lezhe me kapital z.Zef Shtjefni 7 000 000 (shtate milion) leke te reja dhe z.Armando Bonetti me 23 000 000 (njezet e tre milione)leke te reja.

Kete veprimtari private do ta ushtrojne ne fushen e prodhimit dhe shitjes se materialeve te ndertimit e aktivitete te tjera te lidhura me te si;shitblerje te pjeseve te kembimit, lende te para e ndihmese, karburante e lubrifikante, eksport-import, investime per shitblerje dhe ndertime ne turizem e banesa etj., ne territorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte saj.

Kjo shoqeri do te ushtroje veprimtarine e saj per nje kohe prej 20 vjetesh. Selia e shoqerise eshte ne Lezhe, ne ne Fabriken e Tullave.

President dhe administrator i shoqerise do te jete z.Zef Shtjefni dhe keshilltar z.Armando Bonetti.

G J Y Q T A R E

Donika Deti

(signature)

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANE
NR. VENDIMIT 3193/6

# V E N D I M
## I GJYQTARIT TE VETEM

Ne Tirane, sot me date 18.09.2006, une M Doffa Gjyqtare e gjykates e rrethit gjyqesor Tirane, pasi studjova kerkesen e administratorit te shoqerise "MILIS" shpk.

## K O N S T A T O V A

Se me vendimin nr. 3193 date 31.03.1994, eshte rregjistruar shoqeria "MILIS " shpk, me seli ne Lezhe.
Me ndryshimet perkatese, ortake te shoqerise jane Z.Zef Shtjefni,Gjovalin Shtjefni dhe Arta Shtjefni.
Administrator i shoqerise z. Ded Sthjefni,
Me vendimin date 01.06.2006 te asamblese te ortakeve te shoqerise eshte vendosur :

1. Te behet zmadhimi i kapitalit te shoqerise, qe konsiston ne:
   . perfshirjen e fitimeve 2004- 2005 .
2. Caktimi i zj. Ajeta Shkembi, eksperte kontabel e autorizuar per zmadhimin e kapitalit te shoqerise.
3. Depozitimin e ketyre ndryshimeve ne zyren e regjistrit tregtar.

Cmoj se kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

## PER KETO ARSYE

Ne baze te ligjit nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe nr.7667 date 28.01.1993 "Per rregjistrin tregtar ".

## VENDOSA

Pranimin e kerkeses.
. Depozitimin ne regjistrin tregtar te vendimit date 01.06.2006 te asamblese te ortakeve te shoqerise " MILIS " shpk.
.Te urdherohet zyra e regjistrit tregtar te beje ndryshimet ne kollonen 4 dhe 5, duke bere ndarjen e regjistrimeve nga njeri tjetri me vije te kuqe.
Kunder vendimit lejohet ankim.

GJYQTARE
Majlinda Doffa